



Ministria e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Ekonomisë së
Ujrave Trupi për
menaxhimin e fondeve
IPARD



Masa 3

**INVESTIMI NË MJETE FIZIKE QË KANË
TË BËJNË ME PËRPUNIMIN DHE
MARKETINGUN E PRODHIMEVE
BUJQËSORE DHE PESHKUT**



**MUNDËSI
EVROPIANE PËR
BUJQËSINË
MAQEDONASE
DHE ZHVILLIM
RURAL**



www.ipard.gov.mk, www.ipardpa.gov.mk

Instrument për asistencë të para pranimit për zhvillim rural - IPARD 2014 - 2020

Këtë projekt e zbaton Organi për Udhëheqje me IPARD

rr. Aminta III, nr. 2, Shkup

Financuar nga: Masa Ndihmesë Teknike nga IPARD Programi 2014-2020



Ky projekt është koofinansuar nga
Bashkimi Europian



INVESTIMI NË MJETE FIZIKE QË KANË TË BËJNË ME PËRPUNIMIN DHE MARKETINGUN E PRODHIMEVE BUJQËSORE DHE PESHKUT (MASA 3)

I. Shfrytëzuesit

➤ Personat juridikë

(shoqëri tregëtare të rangut të ndërrmarjeve, mikro të vogla e të mesme, që kanë deri në **250** të punësuar dhe me qarkullim vjetor deri në **50** milionë euro) dhe

➤ kooperativat

Ndërrmarjet që nuk bëjnë pjesë në definicionin “të vogla apo të mesme”, por që kanë më pak se **750** të punësuar dhe që kanë qarkullim vjetor, i cili nuk e tejkalon shifrën prej **200** milionë eurosh, mundet të jenë shfrytëzues, por në këtë rast mbështetja mund të ndahet për investime të dedikuara posaçërisht në mbindërtimin e të gjithë sistemit, në pajtim me standardet relevante të BE-së.



II. Sektorët prioritarë:

- Përpunimi i qumështit dhe produkteve të qumështit;
- Përpunimi i mishit dhe produkteve të mishit (përfshirë vezët dhe shpezët);
- Përpunimi i frutave dhe perimeve (përfshirë patatet, kërpudhat dhe kulturat e bishtajorëve);
- Përpunimi i drithërave, produkteve të mullirit dhe niseshtesë;
- Yndyrëra dhe vajra me origjinë bimore dhe shtazore;
- Musht rrushti, verë dhe uthull;
- Prodhimi i energjisë nga përpunimi i biomasës primare, me origjinë bimore dhe shtazore, me përjashtim të biomasës së produkteve të peshkut.

III. Standardet

Shfrytëzuesit obligohen që në fund të investimit të arrijnë standarde nacionale minimale:

- Për mbrojtje të mjedisit jetësor
- Shëndeti publik
- Mirqënia e kafshëve – e aplikuar në kapacitetet e therrtove dhe
- Përmbushjen e standardeve për mbrojtje gjatë punës.

IV. Qëndrueshmëria ekonomike

Qëndrueshmërinë financiare/ekonomike të investimit, aplikuesi e vërteton përmes:

- **Planit të biznesit.**

V. Pronësi e truallit/objektit

Për truallin dhe/ose objektet që janë subjekt i investimit, aplikuesi duhet të dëshmojë:

- **Pronësinë;**
- **Marrëveshje për qira** (më së paku **7** (shtatë) vjet nga dita e dorëzimit të kërkesës).

VI. Kriteret specifike

- Aplikuesi që propozon investime në sektorin e verërave, duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin për Prodhimin e Verës, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave, para datës së dorëzimit të kërkesës për pagesë;
- Aplikuesi që propozon investime në qendrat e grumbullimit dhe shërndarjes së perimeve, frutave, drithërave dhe qumështit, duhet të jetë i regjistruar në Regjistrin e Blerësve të Prodhimeve Bujqësore, pranë Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave, para datës së dorëzimit të kërkesës për pagesë.



VII. Investime të pranueshme

- **Ndërtim ose rindërtim i ndërtesave dhe pasurive të tjera të patundshme**, që do të përdoren për përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore, (psh. ndërtesa, magazina, te cilat kontribuojnë për sigurimin e hapsirës jetësore ose sigurimin gjat punës dh pajisjeve te nevojshme.
- **Blerja dhe /ose instalimi i makinerive dhe pajisjeve/instrumenteve** për:
 - Klasifikimi, mbledhja, ruajtja dhe ftohja e pikave të grumbullimit;
 - Përpunimi, paketimi, ftohja, ngrirja, tharja, etj. dhe magazinim(përfshirë manipulimin);
 - Futja e produkteve të reja, teknologjive dhe proceseve të reja;
 - Mbrojtja e mjedisit;
 - Prodhimi i energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë;
 - Përmirësimi dhe kontrolli i cilësisë dhe sigurisë së lëndëve të para dhe produkteve të gatshme.
- **Blerjen e rezervuarve special transportues dhe rimorkio për transport** të lëndëve të para përfshir edhe transportin e shpezëve.
- **Blerje dhe/apo instalim i makinerive të reja dhe/ose pajisjeve për mbrojtje të ambientit jetësor** përfshir pajisje për prodhimin e energjis elektrike dhe/ose ngrohjes me përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë.
- **Zhvillim dhe vendosje të infrastrukturës**, në pronën e cila është në pronësi të ndërmarrjes, me qëllim plotësimin e nevojave të aktivitetit prodhues të ndërmarrjes.

Investime të ardhëshme

Aplikuesit mund të dorëzojnë më shumë projekte në kuadër të kësaj mase, gjatë periudhës së zbatimit të Programit, me kusht që, harxhimet maksimale të pranueshme (deri në **4.500.000 euro**) të mos jenë tejkaluar dhe projektet e mëparshme, të jenë përfunduar me sukses, më saktë, t'i jenë paguar shfrytëzuesit.



VIII. Kufiri maksimal i mbështetjes

Kufiri maksimal i mbështetjes financiare, arrin deri në **50%** të harxhimeve të përgjithshme të pranuar të investimit.

Kufiri i sipërm rritet me **10** pikë përqindjeje për:

- Investime në ndërtesa/pajisje me qëllim të përmirësimit të efikasitetit energjetik;
- Investimi në ndërtesa/objekte për prodhimin e bio-energjisë, në rast të përpunimit të prodhimeve (lëndëve të para), si dhe përpunimi i bio masës primare dhe sekondare nga bimët dhe kafshët;
- Investimi në ndërtesa/objekte për prodhimin e energjisë nga burime të tjera të rinovueshme, me qëllim të përmbushjes së nevojave vetanake për energji, në ndërmarrjet e përpunimit;
- Investimi në ndërtesa/objekte për trajtimin e ujit/ujrave të ndotur.

Vlera minimale e harxhimeve të përgjithshme të pranueshme për projektin investues të propozuar - **10.000 euro**.

Vlera maksimale e harxhimeve të përgjithshme të pranueshme për një shfrytëzues për Masën 3 arin deri **4.500.000 euro** për gjithë periudhën e zbatimit të programit.



Ministria e Bujqësisë,
Pylltarisë dhe Ekonomisë së
Ujrave Trupi për menaxhimin e fondeve
IPARD

Formularët e nevojshëm për aplikim mund të merren në:

Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujrave

Tel.: 02/3134-477 lokali 113,114,115, Sektori IPARD

Adresa: Aminta III nr.2, Shkup,

www.ipard.gov.mk

Agjencionin për Mbështetje Financiare të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Tel.: 02/3097-460

Adresa: Brigada e III-të Maqedonase p.n., Shkup

www.ipardpa.gov.mk

Agjencionin për Nxitjen e Zhvillimit të Bujqësisë

Tel.: 047/228-330 dhe 047/228-370

Adresa: Kliment Ohridski, Manastir

www.agencija.gov.mk

www.ipard.gov.mk, www.ipardpa.gov.mk

Instrument për asistencë të para pranimit për zhvillim rural - IPARD 2014 - 2020

Këtë projekt e zbaton Organi për Udhëheqje me IPARD

rr. Aminta III, nr. 2, Shkup

Financuar nga: Masa Ndihmesë Teknike nga IPARD Programi 2014-2020



Ky projekt është koofinansuar nga
Bashkimi Europian

